



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo




**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

## **KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**

**Nr. 02-060/01-0035074-15/26 dt. 29.06.2026**

**Mitrovicë**



Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, nënparagrafi d, dhe nenin 40, paragrafi 2, nënparagrafi c, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ. Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenit 4, 9, dhe 22, të Rregullores së MF - NR. 02/2013 - Për Menaxhimin e Pasurisë jo financiare në Organizatat Buxhetore; neneve 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe 46, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, të Statutit të Komunës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 29.06.2026; sjell këtë:

### **VENDIM**

1. Kuvendi i Komunës duke u bazuar në vlerësimet, rekomandimet e pranuar nga Komisioni për Vlerësim të Pasurisë jo Financiare, duke pasur parasysh se Arsyeshmëria e tjetërsimit të pasurisë duhet të bazohet në faktin që pasuria është e pa përdorshme dhe jashtë funksionit të organizatës buxhetore, duke pasur parasysh që Zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtvizore duke iu nënshtruar normave të zhvlerësimit marrë parasysh faktin se sipas nenit 22, paragrafi 4, nënparagrafi 4.8, të Rregullores së lartcekur norma e përgjithshme e zhvlerësimit për Pajisjet e teknologjisë informative është 3 vite; dhe duke u bazuar në nenin 9, paragrafi 3, nënparagrafi 3.3, laptopët (NB LENOVO V 14-IIL 15-1035G1 14") që janë në posedim të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në mandatin 2021-2025 (gjithsejtë 35 laptopë) tu ipen në formë të dhuratës apo transferit atyre anëtarëve të Kuvendit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Sekretaria e Kuvendit.
3. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

**Mitrovicë**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Safet KAMBERI**

**Dorëzohet:**

**1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit**

**1 x 1 MAPL-së**

**1 x 1 Arkivit**

**Kopje: Kryetarit të Komunës**

